



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 228/18 prot.

Tepelenë, më 03.02.2025

V E N D I M

Nr. 4, datë 30.01.2025

“PËR MIRATIMIN E VLERËS MAKSIMALE TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË DHE TË NIVELIT TË QIRASË MESATARË NË TREG TË LIRË”

Në mbështetje të nenit 8, nenit 24, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, të nenit 38, të ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social”, pika 4/a e VKM nr.362, datë 29.05.2019 për “Kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet Buxhetit të Shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, si dhe Urdhërit Nr 09 datë 28.01.2025 për “Ngritjen e grupit të punës për miratimin e vlerës mesatare sipas strukturës së apartamenteve në treg të lirë” me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

VENDOSI:

1. Miratimin e nivelit të qirasë mesatare mujore në treg të lirë sipas strukturave të apartamentave në territorin e Bashkisë Tepelene, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Cmimi mesatar Lekë
1	Banesa me qira (Apartament tip garsonierë)	Muaj	1	7000
2	Banesa me qira (Apartament 1+1)	Muaj	1	8000
3	Banesa me qira (Apartament 2+1)	Muaj	1	9000
4	Banesa me qira (Apartament 3+1)	Muaj	1	11000

2. Vlera maksimale e subvencionit të qirasë është e barasvlefshme me qiratë mesatare në tregun e lirë sipas vlerave të paraqitura në këtë projekt-vendim.
3. Vendimi KB Nr. 92, datë 21.12.2023 “Për vendosjen e masës së qirasë vjetore për banesat sociale me qira në Bashkinë Tepelenë” shfuqizohet.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet zyra e strehimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

ARBEN GUMENI

Miratuar me 13 (trembëdhjetë) vota

Vota Pro 13 (trembëdhjetë)vota

Vota Kundër -

Vota Abstenim -

Zbardhur më datë 03.02.2025



Nr.	Emërtimi	Nësi	Sasia	Çmimi sipas tabelës
1	Banca meqina (Apartment 1-1)	Muq	1	7800
2	Banca meqina (Apartment 1-1)	Muq	1	2000
3	Banca meqina (Apartment 1-1)	Muq	1	9000
4	Banca meqina (Apartment 1-1)	Muq	1	11500